



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

AC-I-23-0699-A0002

**Në çështjen juridike të:**

**M H dhe H K**, nga Peja - të përfaqësuar nga avokatura "K& P" Sh.p.k me avokatë Xh K dhe I N, Prishtinë.

**Paditësit/ankuesit**

**Kundër:**

**Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP)**, Rr. "Dritan Hoxha" nr. 55, Lakrishte- Prishtinë.

**E paditura**

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), i përbërë nga Mr. Sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësve të parashtruar kundër Aktvendimit të Kolegjit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-III.-23-0232, të datës 10 nëntor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 14 dhjetor 2023, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

- 1. Ankesa e paditësve refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktvendimi i Kolegjit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-III.-23- 0232 i datës 10 nëntor 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për këtë procedurë ankimore.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Më 27 shtator 2023, paditësit nëpërmjet të autorizuarve të tyre, kishin parashtruar në DHPGJSK padi për vërtetimin e pronësisë, kthimin e pronës ose kompensimin e saj për shkak të eksproprijimit/shpronësimit, me kërkesë për caktimin e masës së sigurisë. Paditësit kanë pohuar se përmes rastit të ushtruar në DHPGJSK, me Aktgjykimin e Kolegjit të Shkallës së

parë të DHPGJSK-së, C-III-13-0327 të datës 20 maj 2022, padia e paditësve është refuzuar me arsyetimin se palëve paditëse u mungon legjitimiteti procedural për shkak të mungesës së Aktvendimit për trashëgimi. Sa i përket legjitimitetit të padisë së parashtruesve, ata si dëshmi kanë Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i përgjithshëm nr. CT.nr.13/23 të datës 01 shtator 2023. Me këtë vendim është pezulluar procedura e shqyrtimit të masës trashëgimore, pas vdekjes së të ndjerit Xh A, për shkak të mos ekzistimit të masës trashëgimore. Konstatohet se prej trashëgimitarëve të radhës së parë të trashëgimisë, trashëgimilënsi Xh A ka lënë nipin M H, i cili kishte vdekur më 17 prill 1969. Gjithëashtu paditësit pohojnë se me Aktvendimin e Kuvendit Popullor të Prishtinës nr.01-8701/2339 të datës 23 dhjetor 1959, ishte bërë eksproprijimi i pronave të palujsthme, përkatësisht nacionalizimit të tyre, përmes aktvendimit me të cilin vërtetohet se ngastra kadastrale nr... me sipërfaqe prej 0.61,25 ha, si dhe ngastra nr... me sipërfaqe prej 1.45,69 ha, që gjenden në vendin e quajtur "V C" në Prishtinë, që të dy ngastrat evidentohen në listën poseduese nr..., ZK-Prishtinë, deri në vitin 1959 kanë qenë të evidentuara në emër të Xh S H, mirëpo ato janë eksproprijuar dhe për to nuk është bërë asnjë kompensim, që do të thotë se këto prona janë marrë në mënyrë arbitrare.

Nisur nga shkresat apo dokumenti i pronësisë (tapia) e lëshuar nga Porta e Lartë e Shtetit O e vitit janar-shkurt 1901, konstatohet se prona në sipërfaqe prej 50 dunumve të vjetër (1 dunum baraz me 1.000.m2) është shënuar në emër të Xh i biri S H (parardhësi i parashtruesve të kërkesëpadisë), kjo tapi – dokument i S është lëshuar me qëllim që i njëjti të sundoj në token e tij, që është edhe objekt i kërkesës për kthim të pronës/kompensim, E njëjta gjë konstatohet edhe nga dokumenti i lëshuar nga Arkivi i Serbisë i datës 22 maj 2013, në të cilin ceket se në arkivin e Serbisë gjendet certifikata që përmban aktin e lëshuar nga porta e Lartë e Shtetit Osman e vitit janar-shkurt 1901, në emër të Xh i biri i S H për token e tij, që gjendet në C V Prishtinë, në sipërfaqe prej 50 dunum. Paditësit pohojnë se përmes ekspertizës gjeodezike së bashku me gjykatën në vend shikim do të bëhen matjet e nevojshme që do të konstatohet në mënyrë të saktë identifikimi i pronave objekt shqyrtimi, do të konstatohet se prona një pjesë e lirë e sipërfaqes, ashtu që kjo sipërfaqe e lirë të kthehet tek pronarët legjitim, kurse pjesa e pronës që nuk është e lirë, do të kërkohet kompensimi i saj sipas vlerësimit të ekspertizës së ekspertit.

Andaj, bazuar në këto arsye të cekura si më lartë, paditësit i propozojnë gjykatës që pas shqyrtimit dhe administrimit të provave, të provuarit e fakteve, mjeteve provuese dhe marrjes së provave, ta aprovoj si të bazuar padinë dhe kërkesëpadinë, si dhe të vërtetoj se paditësit janë pronarë të tokave të cekura në kërkesëpadi, të detyrohet e paditura që të kthej pronën

kontestuese, si dhe të detyrohet Zyra e Kadastrit në Komunën e Prishtinës, që t'i regjistroj pronat ngastrat kontestuese, në pronësi të paditësve. Në pamundësi të kthimit të pronave apo të ndonjë pjese të tyre, të detyrohet e paditura, që paditësve t'ia paguaj në emër të kompensimit të dëmit për pjesën e sipërfaqeve të shpronsuara, sipas vlerës reale të saj, e cila do të përcaktohet nga ekspertet gjyqësor përkatës, për pronat e cekura në kërkespadi.

Në kuadër të padisë paditësit parashtruarn edhe një propozim për caktimin e masës së sigurisë, duke pohuar se deri sa të caktohet edhe shqyrtohet kërkesëpadija kalon një kohë e gjatë, anadaj edhe ekziston rreziku që pala e paditur të mos e liroj dhe të vazhdojë që t'i shfrytëzojë pronat që paditësit pretendojnë se janë të tyre. Sipas paditësve, AKP përmes procedurave të privatizimit, mund t'i nxjerr në shitje këto prona dhe në këtë mënyrë i mohon një të drejtë paditësve për kthimin e pronës. Paditësit vlersojnë se janë plotësuar kushtet ligjore të paraparë me nenin 61 të Ligjit nr.06/L086, për Dhomën e Posaçme. Paditësit kanë pohuar se e kanë bërë mjaftueshëm të besueshme ekzistimin e së drejtës subjektive të tyre, për arsye se i padituri në menyrë arbitrare e ka shpronësuar sipërfaqen pronësore kontestuese e cila i takon paditësve.

Në mbështetje të padisë dhe kërkesës për caktimin e masës së sigurisë, paditësit/përfaqësuesi i tyre, dorëzoi kopje të dëshmive si në vijim: Autorizimet e noterizuara prej paditësve, Aktgjykimin nr. C-III-13-0327 të datës 20 maj 2022, Aktgjykimin nr. AC-I-22-0313 të datës 21 qershor 2023, Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Pejë CT.nr.13/23 të datës 01 shtator 2023, Certifikatën e vdekjes e Xh A me nr.ser V 10484708, Vërtetimin e lëshuar nga Zyra e gjendjes civile- Vitomiricë e datës 04 shkurt 2022, Njoftimin nga Arkivi Komunal lidhur më kompensimin e shpronësimit të pronës së paluajtshme, kërkesë nga Avokatura "K&P" Sh.p.k më datë 07 shtator 2023, njoftimin për padi datë 22 shtator 2023, disa deklarata të noterizuara nën betim, Vendimin për Nacionalizim nr.01-8701/2339 ( vërtetuar), datë ( e palexueshme).

Më 12 tetor 2023, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër padisë së paditësit dhe përgjigje në kërkesën për masë të sigurimit, theksoi se i kundërshton të gjitha pretendimet e paditësve duke i konsideruar të pa bazuara në ligj dhe si të tilla duhet të refuzohen. E paditura e njofton DHPGJSK-në se për objektin e njejtë të kontestit dhe më palët e njëjta Kolegji i Shkallës së parë DHPGJSK-së me Aktgjykimin nr.C-III-13-0327 të datës 20 maj 2022, padinë e paditësve e kishte refuzuar si të pa bazuar, ndërsa Kolegji i Apelit me Aktgjykimin AC-I-22-0313 të datës 21 qershor 2023, e kishte vërtetuar këtë aktgjykim, andaj në bazë të këtyre fakteve, AKP konsideron se kjo çështje është e gjykuar dhe për një çështje të gjykuar, nuk

mund të zhvillohet kontest tjetër. E paditura më tej kishte pohuar se paditësit kanë parashtruar kërkesë edhe tek Autoriteti i Likudimit, dhe se AL ka vendosur me Vendimin PRN 111-0019 të datë 08 nëntor 2022, i cili gjendet në shkresat e lëndës, por nuk kemi informata nëse paditësi ka ushtruar ankesë siç ishte udhëzuar.

Nëse gjykata nuk e merrë këtë si çështje të gjykuar, atëherë paraqesim mbrojtjen si në vijim: Paditësit në padi nuk e kanë theksuar bazën juridike me të cilën e mbështesin kërkespadinë, nga kjo rrjedh se padia është parashtruar në kundërshtim me nenin 35.2.4 të Ligjit nr.06/L-086 për Dhomën e Posaqme, si dhe nenit 253 të LPK-së. Paditësit nuk kanë dhënë shpjegime dhe sqarime të arsyeshme se mbi çfarë baze juridike paraardhësi i tyre e ka humbur pronën kontestuese. Lidhur me Vendimin e Kuvendit Popullor të Prishtinës nr.01-8701/2339 të datës 23 dhjetor 1959, konsiderojmë se ngastrat janë në emër të paditurës nga viti 1959, bazuar në vendimin e organeve administrative mbi të cilat e drejta e pronësisë është fituar në pajtim me ligjin dhe ky vendim asnjëherë nuk është zhvlerësuar. Paditësit nuk e provuan se paraardhësi i tyre i ka ndërmarrë veprimet juridike që ta kthejnë pasurinë e kontestuar.

Lidhur me propozimin për masë të sigurimit, e paditura thekson se nuk është përbushur kriteri për lëshimin e masës së përkohshme ngase në propozim duhet të tregohen edhe faktet mbi të cilat mbështetet propozimi si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim. E paditura i propozon DHPGJSK-së që ta hedh poshtë si të pa pranueshme kërkesën për lëshimin e masës së sigurisë.

Më 10 nëntor 2023, Kolegji i Shkallës së parë të DHPGJSK-së kishte marrë Aktvendimin me C-III.-23-0232 të cilin kërkesa për caktimin e masës së sigurimit, ishte refuzuar si e pa bazuar. Në arsyetim të vendimit thuhet se nuk janë plotësuar kushtet e dispozitës së nenit 61 për Caktimin e Masës së Sigurimit, pasi që në këtë fazë të procedurës paditësit nuk kanë ofruar dëshmi të besueshme se ekziston e drejta e pretenduar. Paditësit duhet që të dorëzojnë dëshmi të besueshme se kjo e drejtë mund të dëmtohet menjëherë dhe në mënyrë të riparueshme, nëse nuk miratohet kërkesa e tyre për masë të sigurimit. Pa paragjykuar rrezikun në të ardhmen dhe themelsinë e kërkesës kryesore, një rrezik i tillë tani nuk ekziston, pasi që e paditura nuk ka marrë ndonjë veprim me qëllim të tjetërsimit apo ngarkimit të objektit të kontestit. Paditësi nuk kanë paraqitur apo pohuar asnjë rrethanë, me të cilën do të vërtetohej fakti se paditësit do të pësojnë dëm të menjëhershëm, si dhe do të ketë ndonjë pasojë nëse nuk miratohet kërkesa e tyre për masë të sigurimit.

Paditësit në të ardhmen mund të paraqesin një kërkesë të re për lëshimin e masës së sigurimit, nëse ndryshojnë rrethanat faktike, të cilat rrethana do të vlerësosheshin nga gjykata

dhe nëse e paditura me veprime konkrete tenton ta tjetërsoj apo ngarkoj objektin e kontestit, por tani për tani një rrezik i tillë nuk ekziston. Përderisa paditësit nuk kanë ofruar dëshmi të besueshme se ekziston rreziku për dëm të menjëhershëm, gjykata vlerëson se edhe kushti për dëm të riparueshëm nuk është plotësuar, ashtu siç kërkohet sipas ligjit.

Më 20 nëntor 2023, paditësit/ankuesit kishin parashtruar ankesë kundër këtij aktvendimi për shkak të të gjitha arsyeve ankimore, duke propozuar që të aprovohet ankesa, të ndryshohet ky aktvendim, ose aktvendimi i ankimuar të priset dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Paditësit theksojnë se është fakt notor që AKP-ja përmes procedurave të privatizimit mund të publikoj për shitje këtë prone dhe në këtë mënyrë ua mohon paditësve të drejtën e tyre, mirëpo këtë fakt nuk e ka marrë parasysh Kolegji i Shkallës së parë dhe fare nuk e ka arsyetuar në vendimin e saj.

Paditësit ripërsërisin faktin, që duhej të merrej parasysh nga Kolegji I Shkallës së parë, se paditësit e kanë bërë mjaftueshëm të besueshme ekzistimin e të drejtës së subjektive, pasi që i padituri në menyrë arbitrare e ka shpronësuar sipërfaqen pronësore kontestuese e cila u takon paditësve. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, ankuesit mendojnë se janë të mjaftueshme provat e parashtruara, duke përmendur: Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Pejë, CT.nr.13/23 të datës 01 shtator 2023; Aktvendimin e Kuvendit Popullor në Prishtinë nr.01-8701/2339 të datës 23 dhjetor 1959, Certifikatën e vdekjes nr.ser V..., nr ref..., nr.rendor .. e datës 08 mars 2022,etj. Ankuesit konsiderojnë se kjo masë është e arsyetuar mjaftueshëm dhe se pa caktimin e së njëjtës do të rrezikohej realizimi i së drejtës për shpërblim për paditësin. Është e pakontueshme se pa caktimin e masës së sigurisë dhe atë ndalimin e shitjes apo ngarkimit, tjetërsimit të paluajtshmerisë, objekt kontesti, paditësve u rrezikohet dhe i pamundësohet realizimi i të drejtës së tyre.

Më 29 nëntor 2023, Kolegji i Apelit të DHPGJSK-së e ka dërguar tek e paditura këtë ankesë për përgjigje. E paditura në përgjigjen e saj të datës 30 nëntor 2023, thekson se pala paditëse nuk ka arritur që të ofroj asnjë dëshmi në mbështetje të pretendimeve në padi, apo t'i rrezoj argumentet ligjore të dhëna në vendimin e shkallës së parë të DHPGJSK-së.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa është e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të ligjit nr.06/L086 mbi Dhomën e Posqme të Gjykatës Supreme të Kosovës për qështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Kolegji i Shkallës së parë kishte marrë Aktvendimin me të cilin kërkesa për masë të sigurimit, ishte refuzuar si e pa bazuar me arsyetimin se nuk janë plotësuar kushtet e dispozitës së nenit 61 të Ligjit të DHPGJSK-së, pasi që deri në këtë fazë të procedurës, paditësit nuk kanë ofruar dëshmi të besueshme se ekziston e drejta e pretenduar. Paditësit nuk kanë paraqitur apo pohuar asnjë rrethanë, me të cilën do të vërtetohej fakti se paditësit do të pësojnë dëm të menjëhershëm, si dhe do të ketë ndonjë pasojë nëse nuk miratohet kërkesa e tyre për masë të sigurimit.

Ankuesit nuk pajtohen me gjetjet dhe konstatimet e Kolegjit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së. Sipas ankuesve, është fakt notor që AKP-ja përmes procedurave të privatizimit mund të publikoj për shitje këtë pronë dhe në këtë mënyrë ua mohon paditësve të drejtën e tyre, por këtë fakt nuk e ka marrë parasysh Kolegji i Shkallës së parë.

Ankuesit pretendojnë se kanë ofruar prova të mjaftueshme për ta bërë mjaftueshëm të besueshme ekzistimin e të drejtës së subjektive, për arsye se i padituri në menyrë arbitrare e ka shpronësuar sipërfaqen pronësore kontestuese e cila u takon paditësve.

Kolegji i Apelit pasi që ka shqyrtuar pretendimet ankimore të paditësve, aktvendimin e ankimuar dhe shkresat e landës ka gjetur se ankesa është e pa bazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjor.

Kolegji i Apelit nuk e mbështet pretendimin e ankuesve se ata e kanë bërë mjaftueshëm të besueshme ekzistimin e të drejtës së subjektive, pasi që ky pretendim nuk mbështetet me prova valide, pos togfjalshit se, “i padituri në mënyrë arbitrare e ka shpronësuar sipërfaqen pronësore kontestuese e cila u takon paditësve”. Çlëndore tashmë është gjykuar me Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit AC-I.-22-0313 të datës 21 qershor 2023.

Kolegji i Apelit pajtohet me të gjitha gjetjet dhe konstatimet e Shkallës së parë, se nuk janë plotësuar kriteret ligjore të përcaktuara me nenin 61 të Ligjit të DHPGJSK-së për caktimin e masës së sigurisë. Kolegji i Apelit e konsideron të duhur sugjerimin që u jep paditësve shkalla e parë se ata mund të paraqesin kërkesë të bazuar, nëse ka ndryshime të gjendjes në terren, pasi që tani për tani nuk ka asnjë indikacion për këtë ndryshim.

Për këto arsye si më lartë, ankesa e paditësve refuzohet si e pa bazuar dhe rrjedhimisht vërtetohet aktvendimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Kolegji i Apelit konstaton se, pasi që në këtë rast konkret po vendoset për masë të sigurisë, ky vendim nuk prejudikon zgjidhjen në merita të padisë.

Nga ajo që u tha më sipër, u vendos sin ë dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Taksa gjyqësore**

Paditësit për ankesën e tyre tashmë e kanë paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore para Kolegjit të Apelit, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit të DHPGJSK-së më 14 dhjetor 2023.

**Mr.Sc Sahit Sylejamni gjyqtar kryesues** \_\_\_\_\_